

ANKIM



ANKUES: **Partia Bashkimi Për Të Drejtat e Njeriut**, përfaqësuar nga kryetari z. Vangjel Dule, adresa: Grupi Parlamentar "Aleanca Për Ndryshim", Selia e Kuvendit, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Tiranë, adresa elektronike pbdnj.zyraeshtypit@gmail.com, përfaqësuar nga av. Klodiana Gjyzari, me nr. liçence 12079, NUIS M37002201N, anëtare e Dhomës së Avokatisë Vlorë, me adresë: L. "Hajro Çakërr", Rr. "Sulejman Delvina", përbri Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me adresë elektronike klodianagjyzari@gmail.com.

Dhionisios (Alfred) Beleri, i biri i Petros dhe i Kasiani, i datëlindjes 09.08.1972, lindur dhe banues në Himarë, përfaqësuar nga av. Klodiana Gjyzari, me nr. liçence 12079, NUIS M37002201N, anëtare e Dhomës së Avokatisë Vlorë, me adresë: L. "Hajro Çakërr", Rr. "Sulejman Delvina", përbri Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me adresë elektronike klodianagjyzari@gmail.com.

Kundër vendimit nr. 1878 (80-2025-1895), datë 26.05.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, marrë në çështjen:

PADITËS: 1-Partia Bashkimi Për Të Drejtat e Njeriut
2-Dhionisios (Alfred) Beleri

TË PADITUR: 1-Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
2-Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, pranë KQZ

OBJEKTI: Kundërshtim i vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhës koalicioni "Bashkë Fitojmë", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 04 maj 2023" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të vendimit nr. 20, datë 12.09.2024 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri"

BAZA LIGJORE: Nenet 44 e vijues të ligjit nr. 49/2012 "Për funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Nenet 442 e vijues të K.Pr.Civile.

DREJTUAR: Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Me vendimin nr. 1878 (80-2025-1895), datë 26.05.2025 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë me palët dhe objektin si më sipër.



RR787791233AA

(73)

Me vendimin e gjykatës së shkallës së parë nuk jemi dakord dhe në kundërshtim të tij parashtrojmë sa vijon:

A. Rrethanat e faktit të rezultuara gjatë gjykimit në shkallën e parë.

1. Ankuesi Dhionisios Alfred Beleri, propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, është regjistruar si kandidat për Kryetar të Bashkisë Himarë në zgjedhjet vendore që janë zhvilluar në datën 14 maj 2023, me vendim të KZAZ-së perkatëse. Me vendimin nr.611 datë 25.05.2023 të KQZ është vendosur dhënia e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë ankuesit, i cili ka rezultuar kandidati që ka fituar më shumë vota në votimin e drejtëpërdrejtë datë 14.05.2023.
2. Me vendimin nr. 418 datë 13.06.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë është verifikuar mandati i kërkuesit, si Kryetar i Bashkisë Himarë.
3. Rezulton që shtetasi Dhionisios Alfred Beleri është arrestuar në datën 12.05.2023 dhe nga ajo datë ka qënë në masën e sigurimit “arrest në burg”. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka lejuar ankuesin të kryejë ceremoninë e “Betimit”, veprim i cili shërben për fillimin e ushtrimit të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë.
4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Vendimin nr. 14 datë 05.03.2024 ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit Dhionisios Alfred Beleri për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 328 e 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave, dënimin e tij me 2 (dy) vite burgim. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Dhionisios Alfred Beleri fillon nga dita e arrestimit të tij dt.12.05.2023 dhe të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.”*
5. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me Vendimin nr.26 datë 25.06.2024 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 14 datë 05.03.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”*
6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me kërkesë të shtetasit Eugen Likaj, ka filluar një procedurë administrative, në përfundim të së cilës, me vendimin nr. 69 datë 05.07.2024 ka vendosur: *“Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.”*
7. Vendimi i mësipërm është bërë objekt kundërshtimi me ankimin e drejtuar Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve, i cili, pas shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me vendimin nr. 20, datë 12.09.2024 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vendosi: *“1.Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 me ankues Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut. 2.Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.*

10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri. 3.Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionision (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalizioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 ” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 152 të Kodit Zgjedhor” .

8. Të dy vendimet, si ai nr. 69 datë 05.07.2024 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu edhe ai nr. 20, datë 12.09.2024 i Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë kundërshtuar në rrugë gjyqësore dhe me vendimin e ankimuar nr. 1878 (80-2025-1895), datë 26.05.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është vendosur rrëzimi i padisë.

B. Shkaqet e ankimit

9. Pasi ka kryer një referim të gjerë në aktet ligjore, që vlerëson se rregullojnë, ose duhen marrë në konsideratë në rastin në shqyrtim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se vendimmarrja e KQZ, në bazë të nenit 10 të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”, mbulon pesë raste:
- Rastin e parashikuar nga shkronja “a” e pikës 1 të nenit 10 të ligjit 138/2015, sipas të cilit KQZ refuzon kandidaturën e personit, kur kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje të parashikuara në ligj, verifikohen para procesit të pranimit të kandidaturave.
 - Rastin e parashikuar nga shkronja “b” e pikës 1 të nenit 10 të ligjit 138/2015, kur KQZ heq kandidatin nga kandidimi kur kushtet verifikohen para shtypjes së fletëve të votimit.
 - Rastin e parashikuar nga shkronja “c” e pikës 1 të nenit 10 të ligjit 138/2015, sipas të cilit kur kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje verifikohen pas shtypjes së fletëve të votimit dhe para shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, KQZ shpall pavlefshmërisë e zgjedhjeve në rastin kur keto kushte i përkasin kandidatit fitues, ose shpall faktin e moskandidimit dhe moszgjedhjes kur këto kushte i përkasin kandidatit jofitues.
 - Rastin e parashikuar nga shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 10 të ligjit 138/2015, sipas të cilit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit, KQZ shpall pavlefshmërinë e mandatit të personit të shpallur të zgjedhur dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor.
 - Rastin e parashikuar nga shkronja “d” e pikës 1 të nenit 10 kur kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit, sipas

të cilit KQZ shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se rasti konkret është ai i rregulluar nga shkronja “ç” e pikës 1 të nenit 10 të ligjit 138/2015, pa e vlerësuar këtë dispozitë në raport me situatën e faktit, interpretimit sipas vendosjes sistematike dhe qëllimit real të saj, dispozitat e tjera që gjejnë zbatim në rastin konkret, siç janë nenet 61 dhe 62 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, duke shtrirë kompetencat e KQZ aty ku ligji nuk i parashikon, duke i dhënë një rol kontrollues këtij organi, tej atij që i njeh kuadri i përcaktuar në ligj.
11. Në nenin 6/1 të Kushtetutës është parashikuar se mandatet kushtetuese si ai i kryetarit të bashkisë, mund të ndërpriten vetëm në rastet dhe procedurat e parashikuara në ligje të miratuara me 3/5 të anëtarëve të Kuvendit. Të tilla ligje janë Kodi Zgjedhor, ligji nr. 138/2015 dhe ligji nr. 139/2015.
12. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe ai i KAS pranë KQZ, që e ka lënë atë në fuqi, janë akte administrative të paligjshme, pasi organet administrative vendimmarrëse kanë vepruar në tejkalim të kompetencave që u ka njohur ligji dhe kanë shkelur dispozitat ligjore në lidhje me procedurën administrative të zhvillur pranë tyre.
13. Të dy vendimet e kundërshtuara nëpërmjet padisë janë në shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e kompetencave të këtyre organeve, dhe janë pasojë e diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme. Veçanërisht, përveç sa më sipër, vendimi i KAS është marrë nga një trup jo i rregullt, me anëtarë të gjendur në kushtet e konfliktit të interesit. Për këto arsye, është kërkuar gjyqësisht anulimi i të dy vendimeve të kundërshtuara nëpërmjet kërkesë padisë, bazuar në nenin 109/a, b, dhe “dh” të Kodit të Procedurave Administrative si dhe nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë.
14. Pranohet nga palët e paditura në aktet objekt gjykimi se KQZ ka filluar një procedurë administrative bazuar në kërkesën me nr. 1719 prot., datë 26.06.2023 të shtetasit z. Eugen Likaj nëpërmjet të cilës kërkohet konstatimi i përfundimit të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
15. Bazuar mbi një kërkesë të një shtetasi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka dhënë dy disponime që vijnë në kundërshtim me njëra-tjetrën konkretisht ka disponuar për “shpalljen të pavlefshëm” por edhe për “përfundimin e parakohshëm të mandatit” të mandatit të z.Dhionisios Alfred Beleri. Pra as vetë Komisioneri nuk ka qënë i qartë nëse ka patur mandat z.Beleri dhe nëse e ka ushtruar atë, por megjithatë gjykata e shkallës së parë e ka gjetur vendimin të arsyetuar, si përsa i përket situatës faktike, ashtu edhe përsa i përket ligjit të zbatuar dhe vlerësimeve të organeve administrative të paditura.
16. Siç kemi parashtruar më lart, mandatet kushtetuese mund të ndërpriten vetëm në rastet dhe procedurat e parashikuara në ligje të miratuara me 3/5 të anëtarëve të Kuvendit. Duke i analizuar me radhë 2 llojet e vendimmarrjes së KQZ-së të cituara më lart, bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 139/2015, i cili është ligj i miratuar me shumicë të

cilësuar, rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit, ose “para afatit” siç shprehet vetë neni 61 i këtij ligji, janë taksative. Këto raste kanë të bëjnë me rrethana të tilla objektive si pazotësia e kryetarit të bashkisë për të ushtruar detyrën, për shkak të vdekjes, humbjes së zotësisë për të vepruar, apo rrethana subjektive, refuzimi i kryetarit të zgjedhur të kryejë betimin, mosbanimi në të njëjtën bashki ku është zgjedhur kryetar, kandidimi për deputet, dhënia e dorëheqjes, apo shkarkimi nga Këshilli i Ministrave sipas nenit 62 të të njëjti ligj. Nuk parashikohet që organe të tjera jo kushtetuese, siç është KQZ, të kenë të drejtë të ndërpresin një madat kushtetues siç është ai i kryetarit të bashkisë, pasi neni 61 i ligjit nr. 139/2015 nuk ka lejuar, pra nuk parashikon që mandati mund të ndërpritet edhe në raste të tjera të parashikuara në ligje të veçanta. Pra dispozita nuk është blanket dhe legjislatori nuk i ka njohur rezervë asnjë organi tjetër të parashikojë raste të ndryshme për “përfundimin para kohe të mandatit” kushtetues të kryetarit të bashkisë.

17. Vlen të përmendet gjithashtu që ligji nr. 139/2015 është miratuar pas ligjit nr. 138/2015, në rast se ligjvënësi do të donte që të bënte pjesë ndonjë kompetencë të parashikuar në ligjin nr. 138/2015 në ligjin nr. 139/2015, do ta kishte bërë, pasi tashmë ligji nr. 138 ishte miratuar.
18. Në të gjitha këto raste të parashikuara në nenin 61 të ligjit nr. 139/2015, procedura nuk kalon nëpërmjet KQZ, por këshilli bashkiak (neni 61/3) njofton prefektin, i cili nga ana e vet njofton Këshillin e Ministrave, i cili njofton Presidentin, që zbaton Kodin Zgjedhor. Pra KQZ është hallka e fundit pas Presidentit, për efekt të zbatimit të Kodit Zgjedhor. Në këtë dispozitë, e cila është e vetmja që parashikon “*përfundimin e parakohshëm të mandatit*” të kryetarit të bashkisë, nuk parashikohet rasti i dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë si rast i përfundimit të parakohshëm të mandatit, nuk parashikohet që kërkesa mund të bëhet nga ndonjë shtetas në KQZ, si dhe nuk parashikohet ndonjë vendimmarrje nga KQZ.
19. Në pjesën arsyetuese të aktit administrativ Komisioneri nuk shprehet dhe nuk ka dhënë asnjë konsideratë fakti apo ligji në lidhje me kërkesën e paraqitur e cila e ka vënë në lëvizje, që ka patur për objekt “përfundimin e parakohshëm të mandatit”.
20. Pavarësisht parashikimeve të tilla ligjore, të cilat nuk parashikojnë ndonjë detyrë apo funksion a rol të KQZ në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit të bashkisë, pavarësisht se në pjesën arsyetuese Komisioneri nuk ka dhënë asnjë konsideratë as për objektin e kërkesës as për ligjin e zbatueshëm, në pjesën urdhëruese të vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 është shprehur për “përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, z.Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. Pra qartësisht pjesa urdhëruese e aktit administrativ nuk ka lidhje me pjesën arsyetuese të tij.
21. Nga ana tjetër, nga përmbajtja e vendimit të komunikuar të arsyetuar, konstatohet se KAS nuk i ka kthyer përgjigje shkaqeve të ngritura në ankim nga ankuesit, por ka ngritur çështje të cilat nuk kanë patur lidhje me çështjet e shtruara para tyre për zgjidhje.
22. Bazuar në sa më lart, vendimi i Komisionerit për “përfundimin e parakohshëm të mandatit” të kryetarit të Bashkisë Himarë, lënë në fuqi nga KAS, është marrë në

mungesë të kompetencave që ligji, Kodi Zgjedhor, apo ndonjë ligj tjetër ka parashikuar për KQZ-në, duke shkelur nenin 6/1 të Kushtetutës.

23. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka identifikuar si dispozitë të zbatueshme në rastin konkret shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit 138/2015, por gjithashtu nuk ka përfshirë në arsyetim asnjë vlerësim mbi themelimin e kompetencës së palëve të paditura për shpalljen e pavlefshmërisë së një mandati të dalë nga zgjedhje të rregullta, për arsye të mëvonshme, të palidhura me shkaqe ndaluese të përfshira në formularin e vetëdeklarimit, apo bazueshmërinë ligjore të disponimit të KQZ për përfundimin e parakohshëm të mandatit, i cili nuk përfshihet në vendimmarrjen e parashikuar nga dispozita e mësipërme. Duke qenë se një pjesë e mirë e argumentave të palës paditëse i referohen këtij disponimi të fundit të KQZ dhe gjykata e shkallës së parë nuk i ka trajtuar aspak në vendim, vendimi i ankimuar rezulton i paarsyetuar.
24. Nga gjithë provat e administruara dhe qëndrimet e shprehura në gjykimin e shkallës së parë rezultoi gjithashtu se mbi bazën e të njëjtës kërkesë, e cila kishte për objekt vetëm *“përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë”* dhe pa vendosur nisjen e ndonjë procedure kryesisht, Komisioneri ka vendosur *“pavlefshmërinë e mandatit”*, bazuar në nenin 10/1 të ligjit nr. 138/2015. Kjo vendimmarrje, në këtë pjesë, është në kundërshtim me procedurën administrative të parashikuar në ligjin nr. 138/2015, për mënyrën e ushtrimit të kompetencës për verifikimin e vërtetësisë së të dhënave të formularëve të vetëdeklarimit prej KQZ-së. Ligji nr. 138/2015 është ligj i miratuar me shumicë të cilësuar dhe në të, si dhe në Vendimin nr. 17/2015 të Kuvendit parashikohet procedura e vetëdeklarimit dhe verifikimit të vetëdeklarimit të subjekteve të ligjit nr. 138/2015.
25. Neni 41 i K.Pr.Administrative parashikon se *“1. Procedura administrative fillon kryesisht ose me kërkesë. 2. Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës; b) situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e interesit publik. 3. Procedura administrative konsiderohet e filluar: a) me kryerjen e çdo veprimi procedural nga organi publik në rastin e procedurës së filluar kryesisht; ose b) me paraqitjen e kërkesës përpara organit publik, në rastin e procedurës së filluar me kërkesë.”*, ndërsa neni 42 i K.Pr.Administrative parashikon se *“1. Në rastet kur procedura administrative fillohet nga organi i publik, ky i fundit njofton të gjitha palët në proces për fillimin e veprimeve. 2. Njoftimi, sipas pikës 1, të këtij neni, bëhet me shkrim apo në një takim me palën dhe përmban këto të dhëna: a) adresën postare dhe/ose elektronike të organit publik, që zhvillon procedurën dhe nëpunësin përgjegjës për të; b) informacion lidhur me kompetencën e organit publik, qëllimin e procedurës dhe çështjet për të cilat do të merren vendime; c) palët në procedurën administrative; ç) informacion për të drejtën e njohjes së dosjes dhe zyrën ose vendin ku mund të njihet dosja; d) informacion për të drejtën e palës për të dëgjuar, mënyrat dhe afatin e ushtrimit të kësaj të drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi përfundimtar, në rast se zbatohet një afat i tillë. 3. Kur njoftimi bëhet me takim, organi publik mban*

procesverbal për dokumentimin e veprimit të kryer. 4. Organi publik nuk është i detyruar të komunikojë me palët në rastet kur çështja është "Sekret shtetëror", sipas klasifikimeve të bëra me ligj ose kur në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme komunikimi mund të cenojë efektivitetin e procedurës administrative".

26. Në rastin në shqyrtim nuk rezulton një procedurë e nisur kryesisht nga KQZ, por një procedurë në trajtim të kërkesës së shtetasit Eugen Likaj për "përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë" dhe as është njoftuar, siç kërkon ligji, ndonjë procedurë administrative me objekt "Shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit". Pra, shpallja e pavlefshmërisë së mandatit është kryer pa një procedim të mirëfilltë administrativ, të nisur sipas ligjit.
27. Gjykata e shkallës së parë ka konkluduar, në kundërshtim me provat e marra në gjykim, se procedimi nuk ka nisur mbi kërkesën e shtetasit Eugen Likaj, nisur nga pasqyrimi i tij si person i interesuar në vendimmarrjen e palëve të paditura dhe duke kryer një interpretim të kërkesës së këtij shtetasi në kundërshtim me natyrën e saj, duke e konsideruar "indicie" për organin administrativ, për kryerjen e verifikimeve të parashikuara në ligjin 138/2015. Gjithsesi, mbetet fakti se, **sipas dispozitave të sipërcituara të K.Pr.Administrative nuk ka patur procedim të nisur kryesisht**, interpretimi i procedimit të nisur kryesisht ka rezultuar "domosdoshmëri" për të justifikuar gjykata vendimmarrjen e KQZ për pavlefshmërinë e mandatit, pasi procedimi i nisur mbi kërkesën e shtetasit Eugen Likaj nuk ka patur këtë objekt dhe ndërkohë KQZ është shprehur edhe për objektin e kërkesës, edhe për pavlefshmërinë e mandatit. Përveçse vendimmarrja është kontradiktore, KQZ nuk do të shprehej edhe për kërkesën e shtetasit Eugen Likaj, nëse ajo do të përbënte vetëm indicie për nisjen e një procedimi kryesisht, në bazë të nenit 10, pika 1, gërma "ç" të ligjit 138/2015, që nuk parashikon vendimmarrje të palëve të paditura për përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të bashkisë.
28. Përsa i përket kërkesës së shtetasit Eugen Likaj, ajo nuk plotëson elementët minimalë formalë për t'u pranuar për shqyrtim nga KQZ, pasi nuk përmban gjeneralitetet e kërkesës, apo adresën e tij, pra nuk ka asnjë të dhënë për ta identifikuar nëse është shtetas real, nëse është votues, nëse ka zotësi për të vepruar, etj.. Vetëm pas ngritjes së pretendimeve nga përfaqësuesi i z.Beleri, Komisioneri ka gjetur kopjen e kartës së identitetit të këtij shtetasi, akt i cili nuk ka qënë në kohën e shqyrtimit të kërkesës së tij nga Komisioneri, provuar nga fakti se nuk u është vënë në dispozicion palëve gjatë debatit në seancë dëgjimore. Në gjykim, KQZ paraqiti një kopje të kërkesës, e cila u administrua si provë dhe shihet qartë që i mungojnë elementët formalë për t'u quajtur "kërkesë" dhe për të vënë në lëvizje një organ administrativ. Gjithsesi në çdo rast ky shtetas, i vetëm, nuk është i legjitimuar në paraqitjen e kërkesës së marrë në shqyrtim nga KQZ.
29. Nga gjykata e shkallës së parë nuk janë marrë parasysh sa janë zhvilluar në procedimin administrativ dhe forma e kërkesës së paraqitur pranë KQZ, por është vlerësuar se kërkesa e shtetasit Eugen Likaj është e rregullt nga ana formale, megjithë mungesën e elementeve identifikues të tij në kërkesë, bazuar vetëm në fotokopjen e kartës së identitetit të këtij shtetasi, të paraqitur për herë të parë në gjykim dhe gjithsesi me origjinalitet të pa vërtetuar as në procesin administrativ dhe as në gjykim.

30. Neni 44 i K.Pr.Administrative parashikon se “1. Kur procedura administrative fillon me kërkesë të palës, organi publik duhet të marrë masat e nevojshme për përgatitjen sa më mirë të çështjes. 2. Organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimitimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji dhe në përfundim: a) njofton palën kërkuese me shkrim se kërkesa është pranuar për vazhdimin e procedurës; b) njofton palën kërkuese me shkrim për plotësimin e të metave lidhur me plotësimin e kriterëve formale ligjore, duke caktuar një afat të arsyeshëm. Në këtë rast organi publik ndihmon në mënyrë aktive palën për plotësimin e të metave të konstatuara. Mosplotësimi i të metave brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi pala mund të ankohet sipas procedurës të parashikuar në këtë Kod; c) njofton palën kërkuese se janë të nevojshme veprime të mëtejshme administrative para se të vendosë pranimin ose jo të kërkesës. Në këtë rast organi cakton edhe një afat të arsyeshëm për kryerjen e veprimeve të mëtejshme”.
31. Sipas nenit 7 të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikimi i të dhënave të formularëve sipas nenit 5 të të njëjtit ligj, kryhet nga KQZ me kërkesë të subjekteve që parashikon ky nen. Shtetasi Eugen Likaj, për të cilin nuk ka asnjë të dhënë të gjeneraliteteve të tij, nuk përfshihet në asnjë nga rastet e parashikuara në dispozitat ligjore të cituara më lart. Që të detyrojë KQZ të kryejë verifikimin e të dhënave të formularit të subjektit Dhionisios Alfred Beleri, kërkuesi Eugen Likaj duhet të jetë Kryeministër, Kryetar i Kuvendit etj, (neni 7 i ligjit nr. 138/2015), cilësi që ky shtetas nuk i ka.
32. Gjithashtu kërkesa e shtetasit Eugen Likaj nuk përmban interesin e tij në lidhje me këtë procedurë administrative. Jo çdo shtetas mund t'i drejtohet një organi administrativ për të filluar një procedurë administrative sipas ligjit nr. 138/2015, por vetëm ata shtetas që kanë cilësitë që parashikon ligji. Për pasojë për mungesë të kriterëve formale, bazuar në nenin 12/7 të Kodit Zgjedhor dhe 44 të K.Pr.Administrative, kërkesa duhet të ishte kthyer për t'u plotësuar, kërkuesi duhet të gjente edhe 499 votues të tjerë në Bashkinë Himarë (në rast se ai është i tillë) që të nënshkruanin kërkesën. Në vend që të vepronte sipas urdhërimeve të nenit 44 të K.Pr.Administrative KQZ ka shqyrtuar dhe pranuar kërkesën e një subjekti të palegjitimuar sipas parashikimeve të ligjit, madje vendimmarrja e saj ka tejkaluar kërkesën, duke u shprehur për kërkime të ndryshme, si pavlefshmëria e mandatit.
33. Arsyetimi i KAS në pikën 19 të vendimit, se çdo zgjedhës i Bashkisë Himarë legjitimohet të kërkojë pavlefshmërinë e mandatit të Kryetarit të zgjedhur, nuk shoqërohet me ndonjë dispozitë ligjore ku mbështetet, pasi ligji i posaçëm i përdorur si bazë ligjore për vendimmarrje është ligji nr. 138/2015. Në këtë ligj në nenin 7 të tij nuk është përcaktuar se çdo shtetas mund t'i drejtohet KQZ për verifikimin vërtetesisë së formularit të deklarimit. Ligji nr. 138/2015 është shoqëruar me një Vendim të Kuvendit, akte juridike të miratuara me shumicë të cilësuar. Nuk ka asnjë parashikim në këto akte, të cilat t'i japin të drejtë KAS, një organ administrativ jo i parashikuar apo i përmendur në Kushtetutë, të ushtrojë diskrecion e të parashikojë

rregulla të reja të tjera për mënyrën e zbatimit të ligjit nr. 138/2015 të ndryshme nga ato që ka parashikuar një organ kushtetues ligjvënës si Kuvendi.

34. Ky arsyetim, së pari, është në tejkalim të arsytimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili nuk ka dhënë asnjë argument në lidhje me subjektin që e ka vënë në lëvizje, i cili, referuar dhe pjesës hyrëse të aktit administrativ objekt kundërshtimi, ndryshe nga sa arsyeton gjykata e shkallës së parë, rezulton të jetë përcaktuar si “kërkues” nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
35. Së dyti, mbështetet mbi të dhëna që nuk ndodhen në aktet që janë marrë në shqyrtim. Nuk ka asnjë të dhënë që shtetasi Eugen Likaj, që ka vënë në lëvizje KQZ në verifikimin e kushteve të zgjedhshmërisë së z.Beleri të jetë votues në ndonjë bashki të Republikës së Shqipërisë, pasi kërkesa e depozituar në datën 25.06.2024 në KQZ nuk ka asnjë të dhënë, as emrin e kërkuesit. Vetëm në faqen e dytë të kërkesës gjendet emri Eugen Likaj dhe një nënshkrim. Nuk ka asnjë të dhënë për vendbanimin e këtij shtetasi.
36. Së treti gjatë procedurës administrative para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ky shtetas nuk u paraqit, megjithë “interesi” e tij sipas KAS, ky shtetas nuk paraqiti interes në këtë procedurë.
37. Po ashtu as KAS nuk e ka ftuar këtë shtetas, që sipas KAS ka patur interes në procedurën administrative objekt shqyrtimi. Pra nga provat shkresore, nga vetë kërkesa e shtetasit Eugen Likaj, nuk mund të arrihet në konkluzionin as nëse ekziston ky shtetas, por dhe nga sjellja e tij, në rast të ekzistencës së tij reale, ky shtetas nuk ka paraqitur asnjë interes në këtë procedurë administrative.
38. Në kushtet e mësipërme, arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton i gabuar dhe në tejkalim të provave të paraqitura në gjykim, pasi ndërkohë që shtetasi Eugen Likaj nuk legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, KQZ dhe KAS ka vendosur sipas kërkesës së këtij shtetasi, pa nisur asnjë procedurë kryesisht, në çdo rast pa respektuar parashikimet e ligjit për nisjen e procedurës kryesisht (nenet 41 dhe 42 të K.Pr.Administrative) dhe duke tejkaluar vendimmarrjen e parashikuar në nenin 10, pika 1, gërma “ç” të ligjit 138/2015.
39. Përsa i përket vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë se ligji nuk ka parashikuar ndalim për subjektet që nuk kërkojnë verifikimin e të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, për të kërkuar që organi publik të kryejë verifikime dhe të disponojë për ngjarje dhe fakte që kanë ndodhur pas dorëzimit të formularit të deklarimit, por që përfshihen në sferën e ligjit 138/2015, ky interpretim pamundëson zbatimin e ligjit sipas qëllimit të tij. Vetë ligji 138/2015, në nenin 7 të tij, u referohet institucioneve, subjekteve të caktuara të së drejtës, grupimeve të caktuara të interesit, të përmendura në mënyrë shteruese, si të legjitimuara në kërkimin e verifikimit të rasteve ndaluese për zgjedhjen në funksione publike. Ky legjitimim është e qartë se u referohet gjithë rasteve të ndalimit dhe nuk ka kuptim t'i diferencojë ato në raste ekzistuese në kohën e deklarimit, apo në raste të ndodhura më pas (që nuk janë as objek verifikimi nga KQZ), ku kufizimet në legjitimimin e kërimit të verifikimit, sipas gjykatës, nuk ekzistojnë më. Nëse verifikimin mund ta kërkojë kushdo, atëherë cili qëllimi i dhënies të së drejtës për të vënë në lëvizje procesin e verifikimit institucioneve, subjekteve apo grupeve të caktuara të interesit, sipas nenit 7 të ligjit 138/2015 dhe ku do të

qëndronte arsyeja e ligjit për kufizimin e legjitimitetit në kërkimin për verifikim të rasteve ndaluese?

40. I gabuar dhe i pabazuar në ligj rezulton edhe vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë se kërkuesi nuk ka kërkuar verifikim të të dhënave të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, por ka kërkuar verifikim dhe vendimmarrje për fakte të ndodhura pas dorëzimit të formularit nga paditësi Dhionisios Alfred Beleri (pika 23.2.2 e vendimit) dhe se pretendimet e paditësve lidhur me kompetencat e KQZ janë të pabazuara në ligj, pasi, sipas gjykatës, në nenin 10 të ligjit 138/2015 është parashikuar se KQZ është organ kompetent për të shpallur pavlefshmërinë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit, jo vetëm për atë që është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, por në çdo rast të konstatimit të ekzistencës së kushtit të ndalimit sipas ligjit nr. 138/2015, pavarësisht momentit kur ka lindur shkak i ndalimit të kandidimit (pika 20.4 e vendimit).
41. Siç kemi parashtruar gjatë gjykimit në shkallën e parë, veç problemeve procedurale të vendimmarrjes së KQZ, aktet administrative të kundërshtuara janë të paligjshme, pasi janë të pabazuara në bazën ligjore mbi të cilën kanë mbështetur vendimmarrjen e tyre. Sipas ligjit nr. 138/2015 Komisioneri verifikon kushtet e zgjedhshmërisë vetëm mbi bazën e të dhënave të formularëve të plotësuar nga subjektet pjesëmarrës në zgjedhje, dhe ky verifikim kryhet duke ia dërguar Prokurorisë së Përgjithshme. Vendimi i Komisionerit nr. 324 për të filluar verifikimin e thelluar të të dhënave të formularit për kandidatin Dhionisios Alfred Beleri është marrë në datën 12.04.2023. Argument për këtë përbën neni 5 dhe shprehja e nenit 7 të ligjit 138/2015, në vijim dhe në funksion të të cilave vjen vendimmarrja e parashikuar në nenin 10 të këtij ligji.
42. Pas marrjes së të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme, Komisioneri kishte kompetencën brenda afateve ligjore të merrte vendim në lidhje me mbylljen e procedurës së verifikimit të të dhënave të formularit të vetëdeklarimit.
43. Interpretimi i ligjit prej KQZ (Komisionerit dhe KAS) dhe më pas prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është bërë në mënyrë të shkëputur, duke moszbatuar parimet e përgjithshme të interpretimit të ligjeve. Dispozitat ligjore interpretohen në mënyrë sistematike. Në nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, parashikohet detyrimi i subjekteve të ligjit, të vetëdeklarojnë faktet që mund të përbëjnë shkak për të moskandiduar apo për të mos u zgjedhur a mosushtuar funksionin, më tej në nenin 6, është parashikuar organi kushtetues për nxjerrjen e formularëve, në nenin 7 parashikohen subjektet që mund të kërkojnë verifikimin e formularëve, në nenin 8 janë parashikuar organet e ngarkuara me ligj për kryerjen e verifikimit, në nenin 9 detyrimi i çdo institucioni të bashkëpunojë me organet e ngarkuara me ligj për të kryer verifikimin e vërtetësisë së formularëve dhe në nenin 10 janë të parashikuara "veprimet e organit kompetent kur verifikohen kushtet e ndalimit", pra vendimmarrja e KQZ në rastet kur konstaton të dhëna të ndryshme nga sa kanë vetëdeklaruar subjektet.
44. Ligji nr. 138/2015 në nenin 10/1 gërma "ç", që është baza ligjore mbi të cilën është mbështetur vendimmarrja e KQZ, parashikon ndalimin për të kandiduar, zgjedhur apo ushtuar funksionin, dhe ky ndalim mund të konstatohet, duke u nisur nga të dhënat e

formularëve të vetëdeklarimit, në momentin e kandidimit, që passjell dhe përjashtimin nga procesi zgjedhor, ose pavlefshmërinë e mandatit në rast se konstatimi kryhet pas përfundimit të procesit zgjedhor, gjithmonë bazuar në të njëjtat të dhëna.

45. Në lidhje me pengesa të tjera që mund të kenë subjektet, që nuk kanë lidhje me formularët e dekriminalizimit, janë ligje të tjera, organe të tjera kushtetuese që ushtrojnë funksionin, por nuk është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Për çështjen objekt gjykimi nuk ka rëndësi nëse z.Beleri ka pengesë për të kandiduar në të ardhmen, në procese zgjedhore të tjera, të cilat kryhen pasi vendimi i dënimit të tij ka marrë formë të prerë.
46. KQZ (Komisioneri dhe KAS) kanë kryer interpretim të zgjeruar të ligjit nr. 138/2015, pasi vendimmarrja bazohet vetëm tek neni 1 i këtij ligji, qëllimi i ligjit. Ndërkohë që ligji nr. 138/2015 përmban dispozita të përgjithshme, siç është neni 1, “qëllimi i ligjit”, dispozita materiale, të cilat janë dispozitat që parashikojnë rastet e ndalimit, dhe dispozita procedurale, të cilat parashikojnë mënyrën dhe organet e ngarkuara për zbatimin e këtij ligji, si dhe vendimmarrjet për secilin nga rastet e konstatuara.
47. Ligji nr. 138/2015 ndalon ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, nga personat që nuk plotësojnë kriteret e pastërtisë së figurës sipas këtij ligji, por organet që e konstatojnë këtë papajtueshmëri janë të ndryshme, si dhe procedurat janë të ndryshme në varësi të funksionit përkatës. Po ashtu ky ligj ka të përcaktuar dhe një trajtim të ndryshëm për subjektet që ishin në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilët zbatohet ndryshe, në dallim me subjektet të cilët kandidonin për funksionet publike përkatëse pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.
48. Përveç sa më sipër dhe referuar shkakut të përdorur në rastin konkret për të vendosur pavlefshmërinë e mandatit të paditësit dhe përfundimin e parakohshëm të tij, rezulton se vendimmarrja e KQZ dhe KAS ka pasojë shmangien e zbatimit të neneve 61, pika 1, gërma “ç” dhe 62 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përsa KQZ, për të njëjtin rast, merr një vendim të ndryshëm nga ai që ligji përcakton se duhet të merrej nga Këshilli i Ministrave. Në këndvështrim të parimit kushtetues të shtetit të së drejtës, ky rezultat është i papranueshëm.
49. KQZ (Komisioneri dhe KAS) kanë trajtuar në vendimet e tyre rastet e parashikuara në nenin 61 dhe 62 të ligjit nr. 139/2015 si dhe në nenin 115 të Kushtetutës, dhe arsyetojnë meqënëse z.Beleri nuk ia merrnin dot mandatin me këto ligje, atëherë përdorimi i një paragrafi të një neni të ligjit nr. 138/2015 duke e shkëputur tërësisht nga ligji nr. 138/2015, legjitimonte qëllimin.
50. Në të dy vendimet e KQZ (Komisionerit dhe KAS që e ka lënë në fuqi) nuk arsyetohet në lidhje me kompetencën vendimmarrëse të KQZ-së, ashtu edhe të llojit të vendimmarrjes në këndvështrim të një rregullimi ligjor konkret. KQZ është shprehur për pavlefshmërinë dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të ankuesit, të cilat janë raste të ndryshme, për pasojë vendimeve u mungojnë elementëve të detyrueshëm të aktit administrativ dhe si rrjedhojë të paligjshëm, sipas neneve 99, 100 e 109 të K.Pr.Administrative.
51. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në vendimin nr. 69 datë 05.07.2024, lënë në fuqi me vendimin nr. 20 datë 12.09.2024 të KAS, i ka dhënë organit administrativ kompetenca që nuk i ka.

52. Nga ana tjetër, gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar të ligjshme vendimet e palëve të paditura dhe duke u shprehur për kompetencë vendimmarrëse të tyre në rastin e z. Beleri, ka zbatuar keq ligjin.
53. Referuar përmbajtjes së të dy vendimeve pranohet që z.Beleri nuk ka patur pengesë për të kandiduar për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023. Pranohet që vendimi i dënimit të tij është i një viti më vonë, për pasojë nuk kishte lindur detyrimi i pasqyrimin të këtij dënimi në formularin e vetdeklarimit për efekt të ligjit nr. 138/2015. Pra nuk mund t'i nënshtrohet zbatimit të ligjit nr. 138/2015, nenit 10 të tij, vlefshmëria ose jo e mandatit të fituar në vitin 2023, për shkak të dënimit të tij në vitin 2024, pasi ligji nr. 138/2015 parashikon pengesat për kandidim, që ekzistojnë para kandidimit, para procesit zgjedhor. KQZ arsyeton në vendimet objekt kundërshtimi se meqënëse z.Beleri nuk mund të kandidojë në të ardhmen, ai nuk mund të ushtrojë as në të tashmen mandatin tashmë të fituar, pasi sipas KQZ, nuk do të ishte "interpretim logjik" i përmbajtjes tërësore të ligjit nr. 138/2015. Sakaq, përveçse mandati është i vlefshëm përse është rezultat i zgjedhjeve të rregullta, siç përmendim në mënyrë të përsëritur, nuk është në asnjë rast në sferën vendimmarrëse të KQZ-së sipas nenit 10, pika 1, gërma "ç" të ligjit 138/2015 përfundimi i parakohshëm i mandatit, sidomos në rastin kur ligji parashikon se duhet të jetë rrjedhojë e shkarkimit të kryetarit të Bashkisë nga Këshilli i Ministrave.
54. Pra, KQZ i ka dhënë vetes diskrecion që nisur nga qëllimi i ligjit nr. 138/2015 ta shtrijë zbatimin e tij edhe për raste që nuk janë të parashikuara në këtë ligj, duke ushtruar kompetenca që nuk i janë dhënë, sepse ndryshe "nuk do të ishte "interpretim logjik" i përmbajtjes tërësore të ligjit nr. 138/2015".
55. Në nenin 3 të K.Pr.Administrative parashikohet se "...3. "Diskrecioni i organit publik" është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon njesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik...". Në nenin 138/2015 nuk ka asnjë dispozitë që t'i japë të drejtë Komisionerit të kryejë vlerësime, duke u bazuar në qëllimin e ligjit, siç ka kryer në rastin konkret. Ligji nr. 138/2015 ndërpret funksione kushtetuese, ndër të tjera është ai i kryetarit të bashkisë, i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli, për pasojë nuk mund të interpretohet se ligji i ka lënë diskrecion një organi administrativ, si Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, të vlerësojë apo të kryejë interpretim të zgjeruar të ligjit dhe të ndërpresë këto funksione. Neni 6/1 i Kushtetutës parashikon shprehimisht që mandatet kushtetuese ndërpriten në rastet dhe procedurat që parashikohen në ligje të cilësuar, duke i dhënë mbrojtje të posaçme institucioneve kushtetuese, që të mos mbeten në vullnetin apo interpretimin e organeve administrative.
56. KQZ (Komisioneri dhe KAS) ngrejnë pyetje dhe përgjigjen, për çështje të cilat ligji nr. 138/2015 nuk ia ka dhënë atyre për zgjidhje. Nuk i ka dhënë të drejtë ligji nr. 138/2015 Komisionerit të zgjidhë rastet kur subjektet e këtij ligji dënohen penalisht gjatë kryerjes së detyrës, janë organe të tjera kushtetuese që funksionojnë në këto raste, ndaj dhe pyetjet e shtruar prej Komisionerit nuk kanë lidhje me kërkesën që i është paraqitur për zgjidhje dhe diskrecionin që ligji nr. 138/2015 i ka njohur. Po ashtu dhe konstatimet e KAS se përfaqësuesit e z.Beleri nuk kontestojnë faktin e

dënimit të tij në vitin 2024, nuk ka lidhje me çështjet e shtruar për zgjidhje, pasi ligji nr. 138/2015 ka efekt vetëm për dënime të dhëna para kandidimit, dhe të fshehura nga kandidati në formularin e vetdeklarimit.

57. Vendimi nr.69 datë 05.07.2024 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, lënë në fuqi me vendimin nr. 20 datë 12.09.2024 të KAS, ka cënuar nenin 4 të Kodit të Procedurave Administrative sipas të cilit: *“1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor”*.
58. Konfirmimi i kompetencës së KQZ (Komisioneri dhe KAS) nga gjykata e shkallës së parë për konstatimin e pavlefshmërisë së mandatit dhe ndërprerjen e parakohshme të tij, pas përfundimit të procesit zgjedhor, por përpara nisjes së ushtrimit të mandatit, përveçse i kryer në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, shkakton edhe përplasje kompetencash dhe vendimmarrjesh të organeve të ndryshëm administrativë. Kjo pasi aty ku ligji 139/2015 parashikon se Këshilli i Ministrave mund të merrte vendim të shkarkimit të z. Beleri, duke përfunduar mandati i tij në mënyrë të parakohshme, KQZ ka vendosur njëkohësisht si pavlefshmërinë e mandatit të z. Beleri, ashtu edhe përfundimin e parakohshëm të tij. Përveç se kompetencat e këtyre organeve, apo atyre të përmendura në nenin 61 të ligjit 139/2015, janë të ndara dhe parimi i ligjshmërisë (neni 4 i K.Pr.Administrative), përsa parashikon se ato duhet të ushtrohen siç parashikohen në ligj, nuk lejon mbivendosjen e tyre nëpërmjet argumentimeve të bazuara në qëllimin e ligjit, në vendimin e shkallës së parë nuk është përfshirë asnjë lloj arsytimi lidhur me vendimmarrjen e KQZ, edhe për atë që ligji e parashikon si pasojë të vendimmarrjes që i'a rezervon specifikisht Këshillit të Ministrave.
59. Vlerësimi i gabuar i gjykatës së shkallës së parë rezulton akoma më i qartë në atë që ai e konsideron rastin e pestë për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit (pika 18.2.1.5 e vendimit), kur gjykata vlerëson se sipas shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 10 të ligjit 138/2015, KQZ-së i përket kompetenca vendimmarrëse për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit edhe në rastin kur kushtet e moskandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës, kuptohet, sipas pjesës tjetër të arsytimit, edhe kur këto kushte nuk lidhen me formularin e vetëdeklarimit, por me ngjarje të mëpasshme. Pra, është e qartë se në kundërshtim me shkronjën dhe qëllimin e ligjit, gjykata e shkallës së parë i njeh KQZ-së të drejtën të vendosë përfundimin e parakohshëm të mandatit, aty ku ligji e parashikon si rrjedhojë e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave, sipas nenit 62 të ligjit 139/2015.
60. E vetmja mënyrë e interpretimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor, që do të siguronte shmangien e mbivendosjes së kompetencave, është ajo që argumentojmë, sipas së cilës kompetencat e KQZ kufizohen në rastet e mbuluara nga vetëdeklarimi, apo mungesa e vetëdeklarimit të shkaqeve ndaluese të kandidimit dhe ushtrimit të

funksioneve publike, ndërsa për shkaqe të ndërprerjes së mandatit të fituar në mënyrë të rregullt, që lindin më pas, vendimmarrja u përket organeve të tjera, si në rastin konkret Këshillit të Ministrave për shkarkimin, si shkak i ndërprerjes së mandatit. Vetëm kjo mënyrë interpretimi dhe zbatimi të ligjit do të shmangte paradoksin e situatës ku shpallet i pavlefshëm një mandat i rregullt dhe vendoset përfundimi i parakohshëm i mandatit, në bazë të një dispozite që nuk parashikon vendimmarrje të tillë të KQZ.

61. Vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë dhe zgjerimi i kompetencave të KQZ nuk justifikohet as nga momenti kohor i lindjes së shkakut, ku janë mbështetur vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të KAS.
62. Ligji 139/2015 ka parashikuar si rast ndërprerës të parakohshëm të mandatit edhe mungesën e betimit, pavarësisht se në rastin e z. Beleri nuk jemi përpara refuzimit për betim, apo rastin kur kryetari i bashkisë nuk është më banor i përhershëm i bashkisë ku është zgjedhur, pavarësisht momentit të largimit. Pra, momenti kohor i pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve dhe përpara fillimit të ushtrimit të mandatit nuk vendos kompetencë vendimmarrëse të KQZ dhe as përjashton ushtrimin e kompetencave të Këshillit të Ministrave sipas nenit 62 të ligjit 139/2015, apo të këshillit bashkiak në rastet e tjera.
63. Duhet përmendur gjithashtu unikaliteti i rastit Beleri në mënyrën e shpalljes së pavlefshmërisë së mandatit dhe ndërprerjes së parakohshme të tij, pasi në asnjë rast tjetër të lindjes së shkakut të ndalimit pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve KQZ nuk ka ushtruar këtë kompetencë vendimmarrëse, që pretendon se i takon, tregues ky i pranimit edhe nga palët e paditura, nëpërmjet qëndrimit dhe mënyrës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre, se u mungon kompetenca vendimmarrëse lidhur me mandatin e të zgjedhurit vendor, përveçse kur shkak i ndalimit i referohet të dhënave të formularit të vetëdeklarimit.
64. Pra, për qartësi dhe në përmbledhje të sa më sipër: a) Palët e paditura nuk mund të vendosin pavlefshmërinë e mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Beleri, pasi ky mandat është rezultat i vullnetit të votuesve, të shprehur në zgjedhje të rregullta, i konfirmuar edhe nga KQZ dhe gjykata, duke mos u ndodhur z. Beleri përpara asnjë pengese për të kandiduar, për t'u zgjedhur dhe për të ushtruar funksionin sipas formularit të vetëdeklarimit dhe përse nuk ekzistonte asnjë dënim penal i formës së prerë në ngarkim të tij; b) Palët e paditura nuk kanë kompetencë vendimmarrëse mbi një mandat për shkaqe që nuk lidhen me të dhënat e verifikueshme prej tyre dhe kur mandati është fituar rregullisht, për shkaqe të lindura pas fitimit të mandatit; c) Palët e paditura nuk kanë kompetencë vendimmarrëse për ndërprerjen e parakohshme të mandatit të z. Beleri për shkak të dënimit të tij penal, pasi në dispozitët ligjore të përmendur në vendimet e tyre (neni 10, pika 1, gërma "ç") nuk parashikohet një kompetencë e tillë.
65. Përveç shkaqeve të mësipërme të kundërshtimit të vendimit nr. 20, datë 12.09.2024 të KAS, ky vendim është marrë edhe në kushtet e konfliktit të interesit të njërit prej anëtarëve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve. Konkretisht, anëtari i komisionit, z. Ilirjan Rusmali, nuk duhet të ishte në përbërje të organit vendimmarrës, pasi njëkohësisht ka rolin e Këshilltarit të Presidentit të Republikës, pozicion i pranuar prej tij edhe gjatë debatit të ankimit administrativ në Komisionin e Apelimeve dhe Sanksioneve. Edhe në vendimin nr. 20 datë 12.09.2024 KAS nuk kundërshton faktin që z.Rusmajli është këshilltar juridik i Presidentit. Pikërisht mbështetur në aktin e kundërshtuar përpara KAS dhe në këtë gjykim, vendimin nr. 69, datë 05.07.2024 të KQZ, Presidenti i Republikës ka nxjerrë Dekretin nr. 244, datë 05.07.2024 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë”. Ky dekret është kundërshtuar nga paditësit në rrugë gjyqësore. Nga fakti i mësipërm, qoftë për shkak të rolit të këshilltarit dhe eventualitetit të përfshirjes në procedurën e nxjerrjes së dekretit nr. 244, datë 05.07.2024 të Presidentit të Republikës, vlefshmëria e të cilit është e lidhur me shpalljen të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri sipas vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 të KQZ, të ankimuar në rrugë administrative, qoftë për shkak të marrëdhënies që ka z. Ilirjan Rusmali në rolin e këshilltarit me institucionin e Presidentit të Republikës, është e qartë se vendimmarrja është e paragjykuar dhe se minimalisht ai nuk mund të jetë i paanshëm në gjykimin e tij. Neni 31 i K.Pr.Administrative përcakton se *“1. Nëse nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal të organit publik vëren një nga pengesat e parashikuara në nenin 30. të këtij Kodi, ai njofton menjëherë me shkrim eprorin e tij ose organin kolegjal...”*. Sipas nenit 30 të K.Pr.Administrative *“Nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;...ç) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;...g) nëpunësi publik ose anëtari i organit kolegjal ose personat e përmendur në shkronjën “b”, të këtij, neni kanë marrëdhënie të tilla, të cilat vlerësohen sipas rrethanave konkrete se do të përbënin arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative në shqyrtim;...”*. Duke patur parasysh rrethanat e përmendura, në rastin konkret ka vend për zbatimin e parashikimit të nenit 108 i K.Pr.Administrative, që përcakton se *“Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: ...b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;...”*.

66. Në vendimin e shkallës së parë është arsyetuar se çështja në shqyrtim dhe dekreti nr. 244, datë 05.07.2024 i Presidentit të Republikës janë komplet dy gjëra të ndryshme, se objekt gjykimi nuk është dekreti i presidentit, se presidenti nuk është palë në gjykim dhe se rasti i z. Rusmajli nuk përfshihet në rastet e konfliktit të interesit sipas nenit 30 të K.Pr.Administrative, pasi papajtueshmëria sipas shkronjës “ç” të këtij neni ekziston kur anëtari i organit kolegjal ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues etj. në çështjen në shqyrtim dhe jo në çështje të tjera, që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me rastin që shqyrtohet. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në gjykatë nuk është paraqitur asnjë provë se z. Rusmajli është përfshirë

në nxjerrjen e dekretit nr. 244, datë 05.07.2024 të Presidentit të Republikës. Ky arsyetim është i mangët dhe i gabuar.

67. Nga ana e palës së paditur, apo e vetë z. Rusmajli, nuk ka patur mohim të përfshirjes në rolin e këshilltarit të Presidentit në nxjerrjen e dekretit nr. 244, datë 05.07.2024 të Presidentit të Republikës, akoma edhe në procedurën e zhvilluar përpara KAS. Megjithatë, konflikti i interesit, ndryshe nga sa interpreton gjykata e shkallës së parë, ka të bëjë me pjesëmarrjen në KAS të z. Rusmajli, pra të vendimmarrjes në shqyrtim, ndërsa rastet e konfliktit të interesit, të përmendura nga pala paditëse, nuk kufizohen në rastin e gërmës “ç” të nenit 30 të K.Pr.Administrative. Është e qartë se në pozicionin e këshilltarit të Presidentit të Republikës, emetuesit të dekretit nr. 244, datë 05.07.2024, i cili është kundërshtuar në rrugë gjyqësore nga z. Beleri dhe vlefshmëria e të cilit lidhet drejtpërdrejt me shpalljen të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë për z. Beleri, sipas vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 të KQZ, marrëdhëniet e z. Rusmali me emetuesin e dekretit janë të tilla, që interpretuar objektivisht përbëjnë arsye serioze për njëanshmëri me palët në procedurën administrative të zhvilluar në KAS. Vetë palët e paditura gjatë gjykimit kanë pranuar lidhjen e ngushtë ndërmjet dy çështjeve, madje kanë kërkuar në gjykatë pushimin e gjykimit pasi e kanë konsideruar të njëjtën çështje.
68. Vlerësimet duke referuar, por duke shmangur zbatimin e kuadrit ligjor që rregullon rastin konkret, siç ndodh me nenet 61 dhe 62 të ligjit 139/2015, shmangia nga vlerësimi i gjithë pretendimeve të palës paditëse, siç ndodh me rastet e konfliktit të interesit, mungesa e arsytimit lidhur me vendimmarrjen kontradiktore të KQZ për pavlefshmërinë dhe njëkohësisht për përfundimin e parakohshëm të mandatit, mungesa e arsytimit bazuar në ligj lidhur me kompetencën e KQZ për të vendosur përfundimin e parakohshëm të mandatit etj., e bëjnë vendimin e gjykatës së shkallës së parë edhe të paarsyetuar, pra të marrë në kundërshtim me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikon se: “*Vendimet gjyqësore duhet të jene të arsyetuara...*”, si dhe me praktikën e Gjykatës së Lartë dhe të GJEDNJ lidhur me standartet e arsytimit të vendimit gjyqësor.
69. **Duke u kthyer tek vlefshmëria e akteve administrative objekt gjykimi, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se parimi i shtetit të së drejtës i detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (shih vendimet nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 25, datë 28.04.2014; nr. 23, datë 08.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese).** Në vijim të kësaj jurisprudence, Gjykata thekson se të gjitha organet, e parashikuara ose jo në Kushtetutë, duhet t’i nënshtrohen parimit të kushtetutshmërisë dhe atij të ligjshmërisë, pasi vetëm në këtë mënyrë garantohet shteti i së drejtës. Duke mbajtur parasysh se shteti ka për detyrë respektimin dhe mbrojtjen e bazave (vlerave themelore) të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese është shprehur se organet shtetërore në aktet që miratojnë dhe në veprimet që kryejnë, nga njëra anë, duhet të frymëzohen nga këto vlera themelore (neni 3 i Kushtetutës), por, nga ana tjetër, ato njëkohësisht duhet të respektojnë shtetin e së drejtës, pra që veprimtaria e tyre të jetë e bazuar tek e drejta në kuptimin e gjerë

(*latu sensu*), e cila përfshin jo vetëm Kushtetutën, por edhe kuadrin ligjor respektiv (neni 4).

70. Sa më sipër, tej shkeljeve të tjera ligjore të përmendura dhe analizuara, argumentojnë edhe pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të kundërshtuar, pasi:

-Nuk mund të ketë kundërshti më flagrante të dispozitave që rregullojnë kompetencën se veprimi në mungesën totale të saj, apo duke marrë kompetencat e organeve të tjera;

-Nuk mund të ketë shkelje më të rëndë të procedurës sesa veprimi mbi bazën e kërkesës së një subjekti të palegjitimuar (pra pa kërkesë), pa nisur një procedurë administrative kryesisht, pa respektuar asnjë të drejtë të subjektit të verifikuar, duke vepruar në kundërshtim me nenet 5 -10 të ligjit nr. 138/2015 dhe duke u shprehur jashtë kufijve të kërkesës, mbi të cilën ka nisur procedimi administrativ;

-Nuk mund të ketë shkelje më të rëndë të kërkesave të ligjit për formën e aktit administrativ, se mungesa e arsytimit ligjor të tij.

-Nuk mund të ketë shkelje më të rëndë të detyrimit për vendimmarrje sipas parimit të objektivitetit dhe me paanshmëri, sesa vendimmarrja në kushte të pastra të pengesave ligjore dhe konfliktit të interesit.

Pavlefshmëria absolute e aktit të kundërshtuar, siç po e vemë në dukje, mund të konstatohet edhe kryesisht prej gjykatës që merr në shqyrtim kërkesë padinë dhe në këto kushte, për të bërë objekt të shqyrtimit të gjitha shkeljet ligjore të sipërpërmendura, po i vemë në dukje gjykatës edhe këto shkaqe.

Për gjithë sa më sipër kërkojmë: Ndryshimin e vendimit nr. 1878 (80-2025-1895), datë 26.05.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë, duke vendosur:

- Anullimin e Vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatisë të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionision (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor koalicioni "Bashkë Fitojmë". për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të vendimit nr. 20, datë 12.09.2024 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues z. Dhionisios Alfred Beleri.
- Shpenzimet gjyqësore palës së paditur.

ANKUES

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut

Kryetar **Vangjel Dule**

Dhionisios Alfred BELERI

Përfaqësuar nga av. **Klodiana GJYZARI**

